



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy

Komentet nga Ministria e Ekonomisë për Rregulla për Mekanizmin Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme (Rregulla për Mekanizmin e BRE).

1. Neni 5 – Lidhur me përgjegjësitë për parashikim dhe balancim për vetë-konsumatorët:

Të parashihet që furnizuesit të jenë përgjegjës për balancim për vetë-konsumatorët, në përputhje me nenin 30 të Ligjit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë.

2. Neni 11, paragrafi 1.9. - Kostot që lidhen me financimin e çdo kostoje shtesë të skemës mbështetëse të Energjisë së Ripërtërishme që parashihet të financohet përmes Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme;

Nga ky formulim është e paqartë se çfarë konkretisht përfshihet në “kostot që lidhen me financimin”. Sugjerojmë të jepen disa shembuj të kategorive të shpenzimeve të cilat mund të mbulohen, edhe nëse lista nuk është shteruese.

3. Neni 12, Paragrafi 1.3 - Të ardhurat nga grantet, donacionet dhe kontributet.
Propozohet harmonizim me Nenin 3, Paragrafin 1.39 të Ligjit për Burime të Ripërtërishme.

4. Neni 13, paragrafët 1 dhe 2 - Borxhi i keq i lejuar.

Mbetet e paqartë se cilat janë shkaqet që çojnë në krijimin e borxhit të keq. Kërkohet sqarimi i shkaqeve të mundshme që konsiderohen të pranueshme.